



Prania / Dorezuar Primiçori/Prilato Received/Delivary	25-03-2022	2	vite god year
Organ /Njësia Organ /Jedinita Org /Unit	Nr Prot R Post Prot No	Shtojca Prllog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
KAMSHICK	1610/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.256/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Kocanëtarë dhe Valentina Kaçandolli-Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1642/19 të datës 16/02/2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.256/2019 të datës 26/04/2019 të parashtruar nga ankuesja [redacted] kundër Vendimit me numër 01-112/02-13756 të datës 04/04/2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Drenasit në çështjen juridike "transfer", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 25/03/2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.256/2019 e datës 26/04/2019 e parashtruar nga ankuesja [redacted]
- II. SHFUQIZOHET** Vendimi me numër 01-112/02-13756 i datës 04/04/2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Drenasit si dhe Vendimi 01Nr.112-11586 i datës 01/03/2019 i Kryetarit të Komunës së Drenasit.
- III. OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Drenasit, që ankuesen [redacted] ta kthej në vendin e punës "Koordinatorë e Njësitit për të Drejtat e Njeriut dhe Zyrtare per Barazi Gjimore dhe Mundësi të Barabarta", Departamenti Administratës së Përgjithshme, sipas akt emërimit me numër 01-120-8263 të datës 08.06.2012.
- IV. OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Drenasit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

A r s y e t i m

Ankuesja [REDACTED] është e punësuar në Komunën e Drenasit sipas akt emërimit me numër 01-120-8268 të datës 08.06.2012 në vendin e punës "Koordinatorë e Njësitit për të Drejtat e Njeriut dhe Zyrtare për Barazi Gjinore dhe Mundësi të Barabarta" në Administratën e Përgjithshme.

Kryetari i Komunës së Drenasit, me datë 01.03.2019 merr vendimin 01Nr.112-11586 me të cilin vendim ankuesja [REDACTED] transferohet përkohësisht nga vendi i punës "Koordinatorë e Njësitit për të Drejtat e Njeriut dhe Zyrtare për Barazi Gjinore dhe Mundësi të Barabarta" në vendin e punës "Shef i Shërbimeve të Kuvendit".

Ankuesja e pa kënaqur me vendimin e datës 01.03.2019 për transferim me datë 01.03.2019 me numër 02-112-11831 paraqet kundërshtimin e saj tek Drejtoresha për Administratë të Përgjithshme, ndërsa me datë 05.03.2019 e njëjta i kthen përgjigje me 01Nr.112-11831, në të cilën përgjigje theksohet se: *"vendimi nr.01-112-11586, i datës 01.03.2019, i kryetarit të komunës së Drenasit është i drejt dhe i bazuar në dispozitat ligjore, andaj duke pasur parasysh organizimin e brendshëm në komunën tonë, juve ju është bërë transferimi në zyrën e kuvendit komunal"*.

Ankuesja [REDACTED] me datë 12.03.2019 parashtron ankesën me numër të protokollit 01-112-02-13756 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Drenasit.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Drenasit me datë 04.04.2019 merr vendimin me numër 01-112/02-13756 me të cilin vendim refuzohet si e pa bazuar ankesa e ankueses.

Ankuesja [REDACTED] e pa kënaqur me vendimin e datës 04.04.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave me datë 26.04.2019 parashtron ankesën me numër të protokollit 2068/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa më datë 28/06/2019 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 16.02.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1642/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 28/06/2019 dhe duke detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 26.04.2019. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 28.02.2022 me numër të protokollit 1027/2022 e ka pranuar Aktgjykimin A.nr.1642/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 03.05.2019, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Drenasit. Komuna e Drenasit më datë 20.05.2019 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar me shkresat e bashkangjitura të lëndës 1/14.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesa e ankueses e datës 26.04.2019 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 04.04.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Drenasit; Vendimi i datës 01.03.2019 i Kryetarit të Komunës së Drenasit; Kundërshtimi i ankueses i datës 01.03.2019; Përgjigjja e datës 05.03.2019; Ankesa e ankueses e datës 12.03.2019 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Drenasit; Kërkesa e ankueses e datës 23.01.2019; E-mail i datës 01.02.2019; 22.03.2019; 26.03.2019; Përgjigjja në kërkesë e datës 01.02.2019; Raporti i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës me Nr. i amzës 223 për ankuesen [redacted] Udhëzim për konsultim i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare për ankuesen [redacted] Komunikata për media e datës 29.03.2019 i Rrjetit të grave të Kosovës; Shkrimi në Drenica Info i datës 30.03.2019; Shkrimi në Drenica online i datës 04.01.2019; Shkrimi në Drenicapress i datës 31.03.2019; Përgatitja profesionale e ankueses; Certifikata e trajnimeve për ankuesen [redacted] Akt emërimi i datës 08.06.2012; Përshkrimi i detyrave të vendit të punës; Formulari i vlerësimit për vitin 2018; 2017; 2016; Kërkesa e ankueses e datës 26.03.2018; Procesverbali i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave si dhe përgjigjja me shkrim nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankueses [redacted] është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses e cila e ka kundërshtuar vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave si dhe ka pretenduar se është shkelur ligji i shërbimit civilë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë dokumentacionit të bashkangjitur nga ankuesja dhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se pretendimet ankimor të ankueses janë të bazuara, sepse Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se, Kryetari i Komunës së Drenasit me rastin e marrjes së vendimit me 01Nr.112-11586 të datës 01.03.2019 ka vepruar në kundërshtim me nenin 4 dhe 5 të Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, sepse me rastin e marrjes së vendimit me 01Nr.112-11586 të datës 01.03.2019 Kryetari i Komunës nuk e ka cekur se sa kohë zgjat transferimi i përkohshëm i ankueses e që një gjë e tillë është e përcaktuar në nenin 4 paragrafin 2 të Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civilë që ceket se: *“Transferimi i përkohshëm mund të zgjatë deri në dymbëdhjetë (12) muaj”,* më tutje nga dokumentacioni të cilin e ka sjell Komuna e Drenasit me rastin e përgjigjes së ankesës së ankueses, nuk ka sjellë dëshmi se ka pas kërkesë për transferimin e përkohshëm të ankueses nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë në njësinë se ku është paraqit nevoja për transferim rrjedhimisht se ku është transferuar ankuesja sipas vendimit për transfer të datës 01.03.2019 ashtu siç është e përcaktuar në nenin 5 paragrafit 7 të rregullores së lartë cekur dhe më tutje sipas paragrafit 8 të po të njëjtit nen është përcaktuar se: *“Nëse aprovohet kërkesa nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil,*



atëherë ajo i drejtohet për aprovim final udhëheqësit më të lartë administrativ, i cili vendos përfundimisht për transferin”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, po ashtu ka konstatuar se ankuesja [redacted] sipas dekretimit të dhënë në seancën mbi shqyrtimin kryesor të datës 16.02.2022 të dhënë në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative ka deklaruar se: “kërkon kthimin në vendin e punës”, rrjedhimisht Kolegji ka konstatuar se ende nuk është shfuqizuar vendimi me numër 01Nr.112-11586 i datës 01.03.2019 i Kryetarit të Komunës së Drenasit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Drenasit me rastin e marrjes së vendimit me numër 01-112/05-13756 të datës 04.04.2019, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative, Rregullores Nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civilë dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: “Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”, dhe me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të po këtij ligji është përcaktuar se: “Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit”.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda, A.nr.256/2019, datë 25/03/2022

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet;

- Ankueses [redacted]
- Kryetarit të Komunës së Drenasit;
- Udhëheqëses së Personelit në Komunën e Drenasit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

